



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**V E N D I M**  
**K.P.P. 747/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.11.2018 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

- Objekt:** Anulimin e procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-82573-08-09-2018, me objekt “*Blerje këpucë për uniformën e Policisë së Shtetit për vitet 2018, 2019, 2020*”, me fond limit 290.155.500 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 05.10.2018, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
- Ankimues:** “Donianna” sh.p.k.  
Pranë Kthesës së Kamzës, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara  
Sheshi Skënderbej Nr. 3, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me këtë procedurë prokurimi, bazuar në nenin 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

Nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10.08.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-82573-08-09-2018, me objekt “*Blerje këpucë për uniformën e Policisë së Shtetit për vitet 2018, 2019, 2020*”, me fond limit 290.155.500 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 05.10.2018, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 05.10.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, ku konstatohet se operatori ekonomik ankimues ka qenë pjesëmarrës në seancën e hapjes së ofertave nga ana e autoritetit kontraktor, ku edhe është njohur me faktin që shoqëria e tij nuk rezulton të jetë pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.3. Operatori ekonomik “Donianna” sh.p.k. në datën 10.10.2018 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar faktin e mosparaqitjes së ofertës së tij në sistemin e prokurimeve elektronike. Konkretisht , duke pretenduar si më poshtë vijon:

*“Te nderuar zyrtare te autoritetit kontraktor shoqeria Donianna me Nipt J62410005G, krijuar ne vitin 1996 me objekt veprimtarie “Prodhim kepucesh”, objekt i veprimtarise se ciles perputhet me objektin e prokurimit me nr reference REF-82573-08-09-2018, ka shprehur interes qe ne momentin e publikimit te procedures ne sistemin elektronik date 10/08/2018 ora 08:00. Dokumentacionet e para te procedures ne fjale kemi filluar ti ngarkojme ne sistem qe me datë 06/09/2018 e ne vazhdim me plotesimin e tyre sipas seksioneve perkatese qe sistemi na dikton.*

*Me date 05/10/2018 ora 09:41 u pranua oferta me te gjithë dokumentacionin ligjor e teknik, dorezuar ne forme elektronike nga ana e subjektit tone. Jemi paraqitur pane Agjensise se Blerjeve te Perqendruara ne oren edhe ne daten e percaktuar per te qene prezent ne procedure e prokurimit, por cuditerisht nga kryesia e KVO na eshte komunikuar se Donianna nuk rezulton ne seksionin e ofertave te dorezuara dhe na eshte kerkuar te mos jemi prezent gjate procedures si dhe na kane urdheruar te terheqim mbrapsht mostrat tona. Ne si operator nuk dime ende shkaqet objektive te perjashtimit nga kjo procedure, pasi referuar te dhenave qe gjeneron llogaria e subjektit tone ne sistemin e APP, na rezulton qe oferta sebashku me dokumentacionin eshte pranuar para perfundimit te afatit limit per pranimin e ofertave. Duam te sjellim ne vemendjen Tuaj qe Shoqeria Donianna ka marre pjese ne nje procedure tjeter paraardhese me po te njejtin Autoritet Kontraktor dhe me po te njejtin Objekt 'Blerje kepuce per uniformen verore per Policine e Shtetit', me nr reference REF-62038-04-11-2018, zhvilluar date 22/05/2018 dhe per te cilen jemi shpallur fitues duke permbushur me korrektesi dhe ne kohe te gjitha detyrimet kontraktore te parashikuara ne kontraten me nr 149/10 date 13/08/2018. Ne keto kushte natyrshem ne si operator ekonomik kemi shprehur gatishmerine per te permbushur me pergjegjesi dhe korrektesi te gjitha kriteret e parashtruara ne dokumentin e DST te procedures ne fjale.*

*Meqenese komunikimi ndermjet Komisionit te KVO dhe perfaqesuesve te Njesise se Prokurimit si dhe personave te autorizuar te subjektit tone eshte bere verbalisht dhe ne kushtet kur ne si operator ekonomik gjithë dokumentacionin ligjor/teknik e kemi paraqitur ne menyre elektronike konform ligjeve dhe rregullave te Prokurimit Publik, shkaku i perjashtimit te Shoqerise Donianna nga procedura e prokurimit eshte e pambeshtetur ne fake dhe prova, pasi ne kemi paraqitur oferten tone brenda afatit ligjor. Sa me siper, perjashtimi i Shoqerise nga procedura e prokurimit pa kryer verifikim paraprak te arsyes te perjashtimit nga procedura eshte i padrejte ne raport me ligjin. Ne keto kushte kerkojme te kryhet hetim administrativ dhe te pezullohet vazhdimi i procedures se prokurimit deri sa te jete bere nje heim i plote ne lidhje me shkaqet dhe arsyet qe kane cuar ne mos marrjen pjese te shoqerise Donianna ne kete procedure prokurimi. Nder te tjera duam te theksojme se llogaria jone si operator ekonomik prane APP ka qene e bllokuar dhe nuk kemi pasur akses direkt pasi kemi derguar dhe na eshte pranuar oferta.*

*Me keqardhje konstatojme se pasi jemi pajisur me nje passëord te ri, ne sistem na reflektohen veprime te cilat nuk paraqesin vullnetin e shoqerise: Ne oren 09:57 nga sistemi jone rezulton e fshire oferta dhe per rrjedhoje mesazhi vijues ne po ne te njejten orar eshte qe oferta rezulton e padorezuar. Dyshojme qe sistemi eshte bere i pakontrollueshem, i pamenaxhueshem nga ana jone, pasi keto te drejta tonat per te pasur akses ne sistem na jane dhene vetem date 09/10/2018 ora 11:18, pas shkreses sone zyrtare per te patur akses. Ne perfundim, ne kushtet kur ne si operator ekonomik kemi paraqitur gjithë dokumentacionin ligjor/teknik/oferten per te cilen kemi marre dhe mesazh konfirmues qe Oferta Ekonomike 4021/06092018 eshte pranuar, nga ana tjeter ju verbalist na komunikuat perjashtimin nga kjo procedure per mosdorëzim oferte, per aq sa ne kemi akses ne sistem vendimi per perjashtim nga procedura eshte i njeanshem.*

*Sa me super kerkojme: 1. Pezullimin e vazhdimet të procedurës së prokurimit. 2. Hetim administrative deri në sqarimine çështjes.*

II.4. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimes, të dorëzuar pranë KPP, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.1016/1 prot., datë 16.10.2018, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimes, duke e refuzuar atë. Ndërkohë që, operatori ekonomik ankimes pretendon se ka marrë dizeni për kthimin e përgjigjes së autoritetit kontraktor në datën 22.10.2018. Konkretisht, autoriteti kontraktor në kthim përgjigje ka argumentuar:

*“Per pretendimin e paraqitur ne ankesen tuaj, perfaqesues te shoqerise suaj, kane pasur takim me persona të autorizuar pane Ministrise se Brendshme, te cilët i kane komunikuar arsyjet pse nuk mund te ishin te pranishem ne hapjen e ofertes dhe gjithashtu nje korespondence perkatesisht kthim pergjigje me shkresen nr.997/prot date 12.10.2018 nga instituzioni yne per kerkesen e bere nga operatori me nr.997 per problemin e hasur, por kjo nuk eshte marre parasysh, dhe keni vendosur ne menyre te perseritur te beni nje ankese ne formatin standard spas ligjit Nr . 9643 date 20.11 2006 "Per prokurimin publik”, i ndryshuar. Fillimisht theksojme faktin se cdo oferte e cila eshte ngarkuar ne menyre te sukseshme ne SPE shfaqet ne momentin e hapjes se ofertave, ndersa ofertat te cilat nuk kane arritur te kalojne kete faze nuk mund te jene pjese ne zhvillimin e metejshem te procedures. Sipas shtojces nr. 1 se hedhur ne sistem ky eshte afati kohor per dorezimin e ofertave “Ne zbatim te pikes 2/te nenit 42 e LPP (I ndryshuar), per procedure e prokurimit Procedure e hapur mbi kufirin e late monetar me objekt “Blerje kepuce per uniformen e Policise se Shtetit ”, afati kohor per dorezimin e ofertave shtyhet per ne daten 05.10.2018 ora 10:00. Ne printimin nga SPE me operatore te cilët kane paraqitur ofertat e tyre, vihet re se operatori ekonomik DONANNA SHPK ndodhet te ofertat e paperfunduara, nderkohe qe duhet te ishte te ofertat e pranuar. Autoriteti Kontraktor ka zbatuar me pergjegjesi dhe ka ndermarre vetem veprime te bazara ne ligj, ne aktet nenligjore dhe ne rregullat e prokurimit giate gjithë ecurise se procedures se prokurimit objekt ankimesi dhe argumentojme me poshte se hapat e ndermarre janë tërësisht ligjore dhe ne zbatim te akteve nenligjore dhe manualeve te prokurimit. Referuar ligjit 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik”, i ndryshuar nenit 30 percaktimeve te pikes 4 [...] nenit 5 pika 2 [...]. Pra, konkretisht mbeshitetur ne bazen ligjore ndryshe nga sa pretendohet prej ankuesit konstatojme se ne asnje rast nuk eshte e mundur teknikisht qe kjo faze te mund te hape para ores se caktuar te vendosur te "Informacioni administrative” dhe si pasoje ne menyre kategorike njesia nuk mund te nderhyje ne pranimin ose jo te ofertave apo manaxhimin e sistemit elektronik te prokurimit ne menyre te tille qe te pengojë apo lejoje nje operator ekonomik te interesuar te marre pjese apo jo ne procedure. Mosdorezimi i ofertes nga ana juaj nuk eshte pergjegjesi e Autoritetit Kontraktor, pasi ky i fundit ka vendosur afatet ligjore brenda kufijve dhe ne respekt te ligjit ne lidhje me pergatitjen hartimin dhe dorezimin e ofertave. Konkluzionet mbeshiteten edhe ne Manual Nr 02, date 06.02.2018 "Per rolin e Administratorit te Sistemit te Autoritetit Kontraktor, per rolin e Nepunesit te autorizuar te Njesise se Prokurimit dhe per rolin e Anetareve te Komisionit te Vleresimit te Ofertave, ne Sistemin e Prokurimit Elektronik" ku pika 3. 6 shprehet se: "Verifikimi i ofertave te dorezuara Vetem ne daten dhe oren e percaktuar si afat i fundit per pranimin e ofertave, nepunesi i autorizuar, mund te beje te perfunduar fazen "Dorezimi i ofertave" per procedure e prokurimit. Nese para afatit te*

*dorezimit te ofertave mund te tentohet qe te mbyllet faza "Dorezimi i ofertave" nga nepunesi i autorizuar, sistemi do t'ju shfaje mesazhin e meposhtem: KUJDES!!! Po perpiqeni te hapni fazen para kohe." Si rrjedhim, asnje ofertues i cili nuk ka paraqitur elektronikisht oferten e tij nuk mund te jete pjese e procedures se prokurimit duke paraqitur mostrat e kerkuara nga AK. Gjithashtu ne zbatim te VKM-ne nr 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" e ndryshuar, neni 78, pika 1 parashikon se [...]. Sa me siper ju si operator ekonomik nuk keni interes te ligjshem ne ankesen e bere por edhe nuk legjitimoheni proceduralisht pasi ankimimi nuk ka objekt per aq kohe sa AK nuk ka marre ose dhene asnje vendim ku eshte demtuar ose rrezikohet te demtohet shoqeria juaj. Ne kuptim te sa me siper, pretendimet e shoqerise DONIANNA SHPK jane te pabazuara ne ligj dhe prova lidhur kjo me mungesen e aksesit qe ka AK ne nderhyrjen ne sistem dhe kategorizimin e subjektit tuaj, si subjekt i cili nuk ka paraqitur elektronikisht oferten e tij dhe si rrjedhoje nuk legjitimohet si subjekt ankimues. Per gjithë sa me siper, per cdo pretendim te operatorit ne lidhje me funksionimin e sistemit elektronik dhe gjetjen e zgjidhjeve pse nuk ka funksionuar gjithmonë referuar pretendimeve ne ankese ju sugjerojme te drejtoheni prane institucioneve te tjera qe administrojne sistemet ne fjale sipas legjislacionit ne fuqi. Ju inkurajojme te merrni pjese ne procedurat te tjera per te cilat ju si operatore keni interes."*

II.5. Në datën 01.11.2018 operatori ekonomik "Donianna" sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur përgjithësisht të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor. Konkretisht si më poshtë:

*"Agjencia e Prokurimit Publik ka shpallur me date 10/08/2018 proceduren e hapur mbi kufirin e larte monetar, me nr.reference REF-82573-08-09-2018, me objekt "Blerje kepuce uniformen e Policise se Shtetit" nepermjet sistemit te prokurimit elektronik (SPE) me fond limit 290,155,500 leke pa tvsh. Shpallja e kesaj procedure prokurimi eshte bere me kerkese te autoriteit kontraktor Agjencia e blerjeve te PerQendruara, ne Ministrine e Brendshme. Meqenese objekti i procedures se prokurimit public "Blerje kepuce per uniformen e Policise se Shtetit", perputhej me objektin e veprimtarise se shoqerise "Donianna" shpk, kemi shprehur interes per pjesemarrje ne kete procedure prokurimi. Jemi loguar ne sistem si nje operator ekonomik me llogarine e perdoruesit dhe fjalekalimin e vlefshem i cili eshte administruar duke zbatuar me korrektesi te gjitha kerkesat e udhezimit te Agjencise se Prokurimit Publik nr.1, date 26.01.2018 "Per regjistrimin e operatoreve ekonomik dhe dorezimin e ofertave ne sistemin e prokurimit public". Ne cilesine e administratores te operatori ekonomik "Donianna" shpk, kam marre masat duke autorizuar nje nga punonjaset tona e cila eshte marre me procedure si me lart, duke ngarkuar ne sistem gjithë dokumentacionin ligjor dhe teknik si dhe dorezuar ato sebashku me oferten ne oren 09:41 te dates 05/10/2018. Ne kete moment, oferta jone ka kaluar te skedari "Tenderat e mi" - "Oferta te dorezuara" dhe kjo eshte e konfirmuar edhe nga mesazhi i sistemit elektronik. Duhet te sjell ne vemendjen tuaj se gjithë dokumentacioni i ngarkuar deri ne momentin e dorezimit te ofertes ne oren 09:41 te dates 05/10/2018 eshte bere nga IP e vetme e shoqerise dhe e autorizuar per gjithë proceduren ka qene vetem nje punonjese. Pasi kemi marre mesazhin konfirmues nga sistemi elektronik se oferta eshte dorezuar dhe pranuar, specialiste te autorizuar nga shoqeria jane nisur dhe kane qene prezente para komision te vleresimit te ofertave te ngritur nga autoriteti kontraktor pikerisht ne oren 10:00 te dates 05/10/2018, duke qene ne pritje te vleresimit te ofertave. Aty na behet prezent verbalisht fakti qe per shoqerine "Donianna" shpk, nuk ka oferte te dorezuar dhe me urdher te komisionit te vleresimit te ofertave jemi urdheruar verbalisht*

per te dale nga salla. Ne kete faze te prokurimit nuk kemi marre asnje njoftim zyrtar apo te mbahej nje proces verbal mbi arsyet dhe shkaqet e perjashtimit nga procedura e prokurimit. Natyrisht shkaqet per mos dorezimin e ofertes perbejne shkaqe qe dalin jashte kontrollit te autoriteit kontraktor dhe te paparashikueshme ne ligji ne kete faze te procedures se prokurimit, por nderkohe perbejne shkaqe qe dalin jashte kontrollit edhe te operatori ekonomik. Megjithate kjo nuk do te thote te mos hetohet dhe se si duhet te operohet ne raste te tilla duke respektuar parimet e barazise dhe te transparences, sipas percaktimit ne rregullat e prokurimit publik nga AK e ne pergjigjen qe kemi marre nga Agjencia e Prokurimit Publik date 12.10.2018, ne llogarine tone ka qene paralelisht i loguar dhe nje IP tjetër, ku pikerisht nga kjo IP eshte bere dhe fshirja e ofertes se subjektit tone ne oren 09:57, ekzaktesisht 3 minuta prepare mbylles se afatit zyrtar per dorezimin e ofertave. Futja, ndryshimi, fshirja ose heqja e te dhenave kompjuterike apo nderhyrja ne funksionimin e një sistemi kompjuterik, me qëllim per t'i siguruar vetes apo te treteve, me mashtrim, nje perfitim ekonomik te padrejte apo per t'i shkaktuar nje te treti pakesimin e pasurise, ne referim te Kodit Penal te Republikes se Shqiperise perben mashtrim kompjuterik (neni 143/b i K.Penal).

Ne referim te nenit 48 "Paraqitja dhe pranimit i ofertave" te ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 ndryshuar, "Per Prokurimin Publik". "Paraqitja e ofertave behet si me poshte

a) ofertat dorezohen me shkrim, dorazi ose permes postes, te nenshkruara dhe te mbyllura ne zarf, me perjashtim te rasteve te permendura ne shkronjen "b" te kesaj pike, kur autoriteti kontraktor, sipas kerkeses, pasi ofertuesit me nje deshmi, ku shenohen data dhe ora e pranimit të ofertës;

b) ofertat dorezohen ne rruge elektronike, sipas percaktimit ne akte nenligjore. 5. Ofertat e marra pas mbarimit e afatit të fundit të paraqitjes se tyre u kthehen te pahapura ofertuesve, qe i kane paraqitur ato." Nese paraqitja dhe pranimit i ofertave ne kete procedure do te ishte sipas nenit 48, pika 4, germa a, operatori ekonomik Donianna shpk do te ishte pjesemarrse ne procedure dhe oferta e saj do te vleresohej sipas ligjit ne raport me ofertat e paraqitura nga operatorët e tjere ekonomik. Ne rastin e kesaj procedure prokurimi paraqitja e ofertave ne rruge elektronike dhe te veprimeve te ndermara ku eshte mundesuar hyrja me mjete e teknika ne faqen e llogarise se operatorit ekonomik pikerisht pas momentit te dorezimit te ofertes ne sistem, dhe nderhyrja direkt pas ketij moment duke ndermare veprime te fshirjes se ofertes dhe te ndryshimit edhe te fjalekalimit pas fshirjes duhet pare ne dy aspekte:

Se pari: Ne raport me ligjin e posacem per prokurimin public.

Ne kete faze te prokurimit natyrshem dikujt i ka interesuar qe ne te perjashtohemi nga procedura e prokurimit per dy arsye pasi vlera e prokurimit ka qene ne kufirin e late monetar dhe per faktin qe ne dy procedura prokurimi me te njejtin objekt prokurimi po nga i njejtin AK oferta e shoqerise Donianna shpk eshte vleresuar si oferta qe permbush kerkesat e tenderit me Nr reference 62038-04-11-2018 "Blerje kepuce per uniformen e Policise se Shtetit" dhe ne tenderin e hapur me nr Reference REF-83243-08-16-2018 "Blerje kepuce per Drejtorine e Pergjithshme te Burgjeve" si oferte qe ploteson kerkesat e objektit te prokurimit me cmimin me te ulet dhe kritereteve te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Ne raport me ligjin e posacem ne jemi ne kushtet kur rrethanat e ceshtjes nuk jane parashikuar ne ligj se ligjvnenesi apo edhe sistemi i ngritur nuk ka parashikuar qe mund te ndodhin edhe raste te tilla sic ka ndodhur pikerisht ne kete procedure prokurimi me ne si operator ekonomik. Pavaresisht kesaj cfare ligji nuk parashikon ne rrethana te tilla ne nenin 1 dhe 2 te ligjit LPP, I ndryshuar parashikohet [...].

*Ne kete aspekt ne jemi diskriminuar jo vetem qe nuk jemi pjesemarres ne kete procedure prokurimi, por mjetet e perdorura per te na skualifikuar nga kjo procedure jane teresisht joligjore. Institucionet e ngarkuara nga ligji duhet ta shikojne rastin qofte ne raport me ligjin e posacem per prokurimin publik pasi oferta e jone nuk eshte hapur ende dhe ne se do te vleresohej mund te sillte mireperdorim te fondeve publike si nje e mire publike. Do ishte ne nderin e AK dhe KPP si autoritet i pavarur qe kjo procedure prokurimi te perseritet se keshtu i sherbeni ligjit dhe i beni NUL gjithë veprimet kriminale kompjuterike te ndermara. Anullimi i procedures se prokurimit do te kthente edhe besimin e lekundur ne lidhje me sigurine e sistemit SPE, pasi per aq kohe sa ceshtja po hetohet, ne si operatore ekonomik kemi te drejten te paragjykojme kedo e kudo që meren me menaxhimin e sistemit SPE.*

*Se dyti: Rruget dhe mjetet e ndermara jane kriminale.*

*Ceshtja tashme po hetohet nga Prokuroria si nje krim kompjuterik dhe ne kete faze fillestare te hetimit eshte evidentuar fakti se veprimet ne sistem SPE ne llogarine e krijuar si operator ekonomik jane kryer jashte IP te shoqerise "Donianna" shpk. Aktualisht ngjarja kriminale po hetohet dhe eshte ende pa autor po do ishte ne nderin qofte te AK, prane Ministrisë së Brendshme qe kane per mision dhe detyre funksionale luften ndaj krimit ta anullojne procedure e prokurimit se keshtu i sherbejne jo vetem ligjit per edhe ceshtjes penale per te cilen eshte ngritur. Finalizimi i kesaj procedure prokurimi ne keto kushte e rrethana do kompromentonte edhe subjektet qe merren me kete procedure te prokurimit. Nuk duhet ta shikoni ankimin tone ne aspektin e ngusht vetem ekonomik te demit qe i ka ardhur shoqerise "Donainna" shpk si operator ekonomik nga nderhyrjet kompjuterike duke e nxjerre jashte procedure, por duet ta shikoni ne raport me nenin 1 dhe 2 te ligjit te posacem per prokurimin publik dhe duhet te shqetesoheni per akin kriminal qe ka ndodhur per te cilen ne jemi me shume te interesuar per te mesuar te verteteten ne lidhje me kete mashtrim kompjuterik te denueshem nga Kodi Penal ne Republiken e Shqiperise. Ju lutemi vleresoheni ceshtjen jo vetem si nje ankim te mirfillte administrativ por edhe si nje ceshtje ku veprimet e ndermara jane te parashikuara ne K.Penal dhe te denueshme si mashtrim kompjuterik. Natyrisht edhe ankimi i paraqitur prane AK ishte per ta vleresuar ankimin ne te dyja aspektet por qe cuditerisht e ka anashkaluar dhe se ka vleresuar objektin shkaqet dhe rrethanat e ankimit. Ne kthim pergjigjen e AK me shkresen nr.1016/1, date 16/10/2018 ne paragrafin e 1, dhe 3 te faqes 3 citon: "Sa me siper ju si operator ekonomik nuk keni interes te ligjshem ne ankesen e bere por edhe nuk legjitimoheni proceduralisht pasi ankimi, nuk ka objekt per aq kohe sa AK nuk ka marre ose dhene asnje vendim ku eshte demtuar ose rrezikuar te demtohet shoqeria juaj." "Ne kuptim te sa me super pretendimet e shoqerise Donianna shpk jane te pa bazuara ne ligj e ne prova lidhur kjo me mungesen e aksesit që ka AK ne nderhyrjen ne sistem dhe kategorizimin e subjektit tuaj, si subjekt i cili nuk ka paraqitur elektronikisht oferten e tij dhe si rrjedhoje nuk legjitimohet si subjekt ankimes."*

*"Per sa me siper per cdo pretendim te operatorit ne lidhje me funksionimin e sistemit elektronik dhe gjetjen e zgjidhjeve pse nuk ka funksionuar gjithmone referuar pretendimeve ne ankese ju sugjerojme te drejtoheni prane institucioneve te tjera qe administrojne sistemet ne fjale sipas legjislacionit ne fuqi."*

*"Autoriteti kontraktor referuar gjithnje shkreses se tyre na inkurajon te marrim pjese ne procedura te tjera per te cilat ju si operator keni interes."*

*Në lidhje me këtë kthim përgjigje duhet të evidentojmë faktin se ankimi nuk është i mbështetur në ligj e ne prova.*

*Shoqeria "Donianna" shpk si operator ekonomik ka pasur interes te ligjshem ne kete procedure prokurimi dhe realisht eshte demtuar duke iu mohuar e drejta per te marre pjese ne tender, kjo per shkaqe qe dalin jashte kontrollit te saj. Autoriteti kontraktor eshte pergjegjes per prokurimin e fondeve publike, ne perputhje me dispozitat e ketij ligji te posacem dhe te akteve nenligjore, te nxjerra ne zbatim te tij. Nese ajo cfare ka ndodhur ne fakt, nderhyrja ne sistem te llogarise te operatorit ekonomik "Donianna" shpk, autoriteti kontraktor (AK) ju duket nje ngjarje per te cilen nuk duhet te shqetesohen pasi nuk ka marre asnje vendim ku eshte demtuar ose rrezikohet te demtohet shoqeria ...ky është nje absurd. Ne vend qe autoriteti kontraktor ta marre e ta vleresoje ankimin në kthim përgjigjen pa bërë fare hetim administrative per aq sa ligji mund tia mundesoje por edhe duhet ta denoncoj edhe vete si rast dhe ngjarje te krimit kompjuterik, ne kthim pergjigje informon se ju nuk legjitimoheni ne kete ankim. Natyrisht shkaqet per mos dorezimin e ofertes dhe te largimit padrejtesisht nga procedura e prokurimit te operatori ekonomik "Donianna" shpk perbejne shkaqe qe dalin jashte kontrollit te autoritetit kontraktor dhe te paparashikueshme as edhe ne ligj por ajo cfare duhet te vleresohej nga AK eshte pikerisht fakti se jane cenuar dhe nuk eshte respektuar parimet e barazise dhe te transparences, sipas percaktimit ne rregullat e prokurimit publik, pasi ne llogarine e operatorit ne sistemin SPE eshte logar nga IP jashte shoqerise duke fshire oferten, ngjarje me natyre kriminale kompjuterike kjo qe nuk ka per autoresi operatorin ekonomik por nga persona me rekorde kriminale, per te cilat duhet te denoncohet jo vetem nga ne si nje ngjarje kriminale por edhe autoriteti kontraktor duhet ta vleresonte si nje ngjarje qe cenon sigurine e sistemit SPE. Pra autoriteti kontraktor ne vend qe te dali me nje vendim per ate cfare kemi kerkuar ne kthim pergjigje te ankese na konfirmon qe nuk kemi interes te ligjshem dhe nuk legjitimoheni ne kete procedure dhe se i kemi lare duart nga kjo procedure duke na inkurajuar per te qene pjesemarres ne procedura te ardhshme.*

*Ne keto kushte bazar ne nenin 63 te LPP, i ndryshuar, po paraqesim ankim para Komisionit te Prokurimit Publik duke i kerkuar qe oferta e dorezuar nga operatori ekonomik te administrohet ne rruge zyrtare nga autoriteti kontraktor dhe te procedohet me vleresimin e ofertave ose te anullohet procedura e tenderimit per te mundesuar pjesemarrjen e plote te nxise konkruencen midis operateve ekonomik dhe jo te legjitimohet dhe te finalizohet ky prokurim me mjete e veprime nepermjet mashtrimit kompjuterik sic ka ndodhur ne fakt per ta nxjerre jashte procedure operatorin ekonomik "Donianna" sh.p.k. sic ka ndodhur në fakt. Anullimi i procedurës së tenderit do të siguronte nje trajtim të barabartë dhe jo diskriminues ndërmjet operatorëve ekonomikë.*

*Date 09/10/2018 i jemi drejtuar Autoritetit Kontraktor me nje shkrese ankese ne formatin e kerkuar, ku i kemi parashtruar faktet dhe provat lidhur me situaten sa me lart. Nga Agjencia e Blerjeve te Perqendruara kemi marre pergjigje me shkrim, protokolluar date 22/10/2018, prot. 359, ku cilesohej nder te tjera: "Modorezimi i ofertes nga ana juaj nuk eshte pergjegjesi e Autoritetit Kontraktor, pasi ky i fundit ka vendosur afatet ligjore brenda kufijve dhe ne respekt te ligjit ne lidhje me pergatitjen hartimin dhe dorezimin e ofertave. Gjendur perballe kesaj suate, kemi vendosur ti drejtohem Komisionit te Prokurimit Publik, si organi me i larte ne fushen e Prokurimit Publik. Bashkengjitur do mund te gjeni kopje te formularit te ankeses derguar Autoritetit Kontraktor si dhe pergjigjen e marre nga Agjencia e Blerjeve te Perqendruara."*

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**



pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur

### Arsyeton

III.1. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson të ndalet në arsyetimin, përse i përket legjitimitetit të operatorit ekonomik ankimues për të paraqitur ankesë, si edhe respektimit të kushteve formale nga ana e këtij të fundit. Vlen të sqarohet se, nisur nga faktet dhe dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi në depozitimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ky i fundit gjykon se ndodhemi përpara një rasti dhe problematike të cilën KPP nuk e ka hasur më parë gjatë shqyrtimit të ankesave të paraqitura për gjykim.

III.1.1. Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, Komisioni i Prokurimit Publik, është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, i cili shqyrton ankesat e operatorëve ekonomikë mbi procedurën e prokurimit ku ata marrin pjesë. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, përfshirë edhe kthimin e përgjigjes së autoritetit kontraktor për trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ankimues pranë këtij të fundit (dokumentacion ky bashkëlidhur ankesës së depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik), konstatohet se emri i operatorit ekonomik “Donianna” sh.p.k. nuk rezulton në listën e operatorëve ekonomikë që kanë dorëzuar ofertë në sistemin e prokurimeve elektronike për këtë procedurë prokurimi, fakt ky i evidentuar edhe nga vetë ankimuesi, i cili deklaron se në llogarinë e tij personale ka një njoftim që oferta e tij është e papërfunduar, ndërkohë që pretendon se ka edhe një njoftim tjetër të mëparshëm që oferta e tij është përfunduar.

Pra sa më sipër, gjendja aktuale në lidhje me ofertën e këtij operatori ekonomik është se në sistemin e prokurimeve elektronike nuk rezulton të jetë paraqitur ofertë nga ky i fundit, e si rrjedhim kjo shoqëri nuk figuron në listën e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për këtë procedurë prokurimi.

III.1.2. Neni 63, pika 2 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: *“Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji”*.

Në kushtet si më sipër cituar, rezulton se, ky operator ekonomik nuk është pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, e për rrjedhim nuk legjitimohet të paraqesë ankesë përse kohë që edhe autoriteti kontraktor nuk ka dalë me një vendim përfundimtar klasifikimi.

Pra në rastin konkret, vërtet operatori ekonomik ankimues ka shprehur interesin e tij për të marrë pjesë në një procedurë prokurimi, por në fazën në të cilën ndodhet kjo procedurë, nuk është kryer asnjë veprim nga ana e autoritetit kontraktor, pra nuk është kryer asnjë vlerësim i ofertave, por është bërë vetëm hapja e tyre, ku autoriteti kontraktor shprehet se oferta e operatorit ekonomik “Donianna” sh.p.k. nuk rezulton të jetë paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike.

Komisioni i Prokurimit Publik, vepron dhe ushtron funksionin e tij brenda tagrave që ia lejon legjislacioni për prokurimin publik, për sa kohë, në fazën në të cilën ndodhet kjo procedurë prokurimi, KPP e ka të pamundur të verifikojë pretendimet që ngre operatori ekonomik ankimues në lidhje me veprimet e ndodhura në llogarinë e tij personale në sistemin e prokurimeve elektronike.

KPP sqaron se, përpara këtij rasti të paprecedent, operatori ekonomik ankimes nuk legjitimohet që të paraqesë ankesë pranë këtij të fundit, si organ i cili shqyrton ankesa vetëm kur interesi i operatorit ekonomik çenohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, për sa kohë autoriteti kontraktor nuk ka ndërmarrë asnjë vendim në lidhje me këtë procedurë prokurimi dhe nuk ka dalë me një vendim përfundimtar në rastin konkret.

Gjithashtu, theksojmë se, Komisioni i Prokurimit Publik, është organ që shqyrton vetëm ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë për vendime të autoritetit kontraktor për procedura të ndryshme prokurimi, dhe nuk shqyrton problematika apo pretendime që kanë të bëjnë me llogarinë e përdoruesit të një operatori ekonomik.

III.2. Nga ana tjetër, duam të sqarojmë se në nenin 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikohet se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”*.

III.2.1. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Edhe pse, ashtu siç analizuam më lart, ky operator ekonomik nuk legjitimohet të paraqesë ankesë pranë KPP-së në lidhje me këtë procedurë prokurimi, nga ana tjetër, nëse do t’i referohemi bazës ligjore si më sipër cituar, duke qenë se ka shfaqur interes për këtë procedurë prokurimi, si një person i interesuar, i sqarojmë, se nuk plotëson kushtet formale edhe si person i interesuar.

Për më tepër, ky operator ekonomik nuk plotëson afatet e ankimit sipas nenit 63 të ligjit për prokurimin publik.

Në ligjin e prokurimit publik janë përcaktuar qartësisht momentet e përlllogaritjes së afateve procedurale, si në rastin e ankesave për dokumentat e tenderit, ashtu edhe në rastin kur autoriteti kontraktor merr një vendim për procedurën e prokurimit. Për shkak të situatës së pazakontë, në kushtet kur autoriteti kontraktor nuk ka dalë me një vendim përfundimtar, atëherë KPP në përlllogaritjen e afateve të ankimit, do t’i referohet datës 05.10.2018 si datë në të cilën ky operator ekonomik është njohur me faktin, se oferta e tij ekonomike nuk rezulton në sistemin e prokurimeve elektronike, duke e konsideruar si datë, që ky operator ekonomik, si person i interesuar, është njohur me shkeljen e pretenduar.

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson të ndalet në arsyetimin, përse i përket respektimit të kushteve formale nga ana e operatorit ekonomik ankimes. Në lidhje me afatet, pas shqyrtimit, rezulton si më poshtë:

III.2.3. Në datën 10.08.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit *“Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”*, me nr. REF-82573-08-09-2018, me objekt *“Blerje këpucë për uniformën e Policisë së Shtetit për vitet 2018, 2019, 2020”*, me fond limit 290.155.500 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 05.10.2018, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

III.2.4. Në datën 05.10.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, ku konstatohet se operatori ekonomik ankimes ka qenë pjesëmarrës në seancën e hapjes së ofertave nga ana e autoritetit kontraktor, ku edhe është njohur me faktin që shoqëria e tij nuk rezulton të jetë pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

III.2.5. Operatori ekonomik “Donianna” sh.p.k. në datën 10.10.2018 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar faktin e mosparaqitjes së ofertës së tij në sistemin e prokurimeve elektronike.

III.2.6. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimes, të dorëzuar pranë KPP, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.1016/1 prot., datë 16.10.2018, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimes, duke e refuzuar atë. Ndërkohë që, operatori ekonomik ankimes pretendon se ka marrë dijeni për kthimin e përgjigjes së autoritetit kontraktor në datën 22.10.2018.

III.2.7. Në datën 01.11.2018 operatori ekonomik “Donianna” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor.

III.2.8. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku është parashikuar: “Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji”. “Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”.

Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.

III.2.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, konstatohet se, ankesa e shoqërisë “Donianna” sh.p.k. është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në datë 10.10.2018. Referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se, ankimi administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik dorëzohet me shkrim brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik nis ditën e nesërme të punës pas përfundimit të afatit të parashikuar nga neni 63 pika 5 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, operatori ekonomik ankimes ka ezuaruar ankim administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda afatit të parashikuar nga L.P.P. Me marrjen e ankesës në dorëzim nga autoriteti kontraktor, ky i fundit ka detyrimin ligjor të shqyrtojë ankesën dhe të marrë një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

Mosrespektimi i afatit të sipërcituar nga ana e autoritetit kontraktor nuk çënon në asnjë rast pozitën e operatorëve ekonomikë ankimues, pasi, kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar edhe momentin procedural të nisjes së llogaritjes së afateve ligjore për ankim administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në rastet kur autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 5 të LPP-së. Sa më sipër, KPP konstaton se, ankimi i dorëzuar pranë KPP-së nga operatori ekonomik ankimues më datë 01.11.2018 është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga *lex specialis*, pasi referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë KPP nis nga dita kur operatori ekonomik ankimues duhet të ishte njoftuar nga autoriteti kontraktor mbi shqyrtimin e ankesës nga ky i fundit, dhe përfundon ditën e dhjetë. Në rastin konkret, afati maksimal i paraqitjes së ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga ana e operatorit ekonomik ankimues është tejkaluar dhe është paraqitur prej këtij të fundit disa ditë më vonë pas përfundimit të afatit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis* në dorëzimin e ankesës pranë KPP-së.

III.2.10. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “Donianna” sh.p.k. pranë KPP- së, nuk ka përmbushur edhe detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” që, referuar nenit 26, pikës 3, shkronja “a”, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.2.11. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III.3. Për më tepër, në kuadër të interesit publik, nisur nga procedura e prokurimit, vlera e saj dhe natyra e kontratës, si edhe për shkak të problematikës së pahasur më parë, sqarojmë se, pretendimet e ngritura shkojnë përtej kompetencave dhe tagrave të Komisionit të Prokurimit Publik, i cili është organi më i lartë në fushën e prokurimit publik që shqyrton ankesat e paraqitura në lidhje me procedurat e prokurimit.

Për shkak të një situatë të pandodhur më parë për gjykim pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke qenë se ky i fundit e ka të pamundur të verifikojë pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues në lidhje me veprimet që kanë ndodhur me sistemin e prokurimeve elektronike, konkretisht në llogarinë personale të përdoruesit të shoqërisë “Donianna” sh.p.k., pasi nuk janë pjesë e hetimit dhe shqyrtimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vlerëson të drejtë faktin që ky operator i është drejtuar organeve të hetimit për sqarimin e situatës së ndodhur.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Donianna” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-82573-08-09-2018, me objekt “Blerje këpucë për uniformën e Policisë së Shtetit për vitet 2018, 2019, 2020”, me fond limit 290.155.500 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 05.10.2018, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
  2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
  3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1675 Protokoli**

**Datë 01.11.2018**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

<b>Nënkryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Enkeleda Bega</b>	<b>Vilma Zhupaj</b>	<b>Lindita Skeja</b>	<b>Merita Zeqaj</b>

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**